

VENDIM
Nr. 141, datë 20.2.2013

**PËR AUTORIZIMIN E MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE
ENERGJETIKËS PËR LIDHJEN E SHITESËS SË KONTRATËS ME STUDIOIN E
AVOKATISË, TË PËRZGJEDHUR PËR PËRFQËSIMIN NË ÇËSHTJEN E
ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR KUNDËR SHOQËRISË “CEZ”, A.S**

(Ndryshuar me VKM nr. 392, datë 2.5.2013)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 pika 7, 5 pika 1 shkronja “b”, 12, pikat 2 e 6, 15 pika 8, dhe 18 pika 2 të ligjit nr. 10 018, datë 13.11.2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) për lidhjen e shtesës së kontratës me studion ligjore ndërkombëtare “Derains&Gharavi”, e cila është përzgjedhur përmes një procedure konkurruese për të ofruar këshillim ligjor për këtë ministri.

2. Objekt i shtesës së kontratës të jetë përfaqësimi i Republikës së Shqipërisë/METE, nga ana e studios ligjore, në arbitrazhin ndërkombëtar kundër shoqërisë “CEZ”, a.s., në cilësinë e paditësit ose të paditurit kundërpaditës.

3. *Shpenzimet për pagimin e studios së avokatisë, në vlerën 900 000 (nëntëqind mijë) euro, për kontratën “Për ofrimin e shërbimeve nga studioja ligjore “Derains & Gharavi””, si dhe për shtesën e kontratës, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit për vitin 2013.*

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Drejtësisë dhe Avokatura e Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha